

RELACION

RRUGA KIKA - BRADOZHNICE

**Faza e l-re
KIKA - QAFE PAJE**

RELACION TEKNIK
PER OBJEKTIN
NDERTIM RRUGA AUTO KIKA TE DRAGOBISE - BRADOZHNICE
(Fazae I-re KIKA TE DRAGOBISE – QAFA E PAJES)

I. PERSHKRIM I PERGJITHSHEM EKONOMIK

Fshati Bradozhnicë i Njesise Administrative Margegaj te bashkise Tropoje eshte një nga fshatrat e rralle ne Shqiperi dhe i vetmi ne rrëthin e Tropojes që nuk ka rrugë automobilistike.

Gjithashtu, ne kete zone apo siper ketij fshati jane edhe te quajturat Livadhet e Shoshanit, nga te cilat jo vetem se merret baze ushqimore per periudhen dimerore, por jane dhe kullota te shkelqyera verore per bagetite.

Nga ndertimi i ketij segmenti rrugor perfitorje, jo vetem banoret e Bradozhnicës, te cilet kane shtepite dhe tokat e tyre ne kete, por edhe banoret e fshatrave Shoshan e Kocanaj që kane livadhe e kollota, si dhe banoret e fshatrave Dragobi dhe Margegaj, te cilet kane stanet verore ne vendet e quajtuara Gjarpni i Dragobise dhe Kosherishte.

Pa perfshire keto te fundit, Gjarpnin e Dragobise dhe Kosherishten, ne zonen e Bradozhnicës dhe Livadhet e Shoshanit, sipas te dheneve statistikore te nxjerra nga Libri i Tokes jane 20 ha, toke buqesore dhe 400 ha, livadhe. Ne kete zone, vite me pare kane sherbyer si kullota per rrëth 1500 koke dele.

Gjithashtu, ne kete zone ka një sipërfaqe te madhe me pyje, ku vlejne per t'u permendur pyjet masive te Lumit te Gashit, te cilat jane një pasuri e madhe kombetare.

Ndertimi i ketij segmenti rrugo, rnekohesishët sherben dhe si brez mbrojtës, ne rast te renies se zjarrit ne pyje per nderprerjen, apo kalimin e zjarrit nga njera ane, ne tjetren.

Nga ndertimi i kesaj rruge perfitorje:

- Banoret e fshatit Bradozhnicë, te cilet, pas hapjes se rruges, një pjesë mund te kthehen per banim te perhershëm, ndersa pjesa tjeter per sezionin e veres. Ky fshat ka te ndertuara 37 shtepi, ne tecilat kane banuar 60 familje.
- Banoret e fshatit Koçanaj, që perbehën nga 50 familje, kane kullotat e tyre ne kete zone, si telen e Rupes Eper, Corropojes etj.
- Banoret e fshatit Shoshan që perbehën nga 60 familje, ku edhe keta kane ishe livadhet e tyre ku dy palet bashke, kapin sasine e lartëpermendor prej 400 ha.
- Banoret e fshatit Margegaj (Lagja Arifaj) te cilat kane pronat e tyre, telen e Kosherishtes, Rupes se Poshter, etj., perbehën nga 118 familje (perfshire ketu dhe Lagjen Klysyre), që kane nevoje per ndertimin e kesaj rruge.
- Ne menyre direkte, jane perfittues një numer i madh familjesh te fshatit Dragobi, te cilet kane telat e tyre si Gjarpri i Dragobise, Gurihuli etj.

Plus sa permendem me lart, ne kete zone jane rrëth 3000 mijë ha pyje, te cilat kane nevoje per sherbime.

Ne kete zone, vlen per t'u permendur ekzistencë e një shumellojshmerie te bimeve medicinale, te calat Jane mjet jetese per shume familje.

Llogaritur ne teresi, interes i ekonomik i kesaj rruge eshte per mbi 60% te popullsise se Njesise Administrative Margegaj, njera nga njesite me te medha ne bashkine Tropoje.

II. TE DHENA TE PERGJITHSHME PER RRUGEN

Ndertimi i kesaj rruge, e cila lidh fshatin e Bradozhdicës e rrëthinat e tij me rrugen nationale Bajram Curri - Valbone do te realizohet sipas parashikimeve që po paraqesim me poshte:

1. Ndertimi i kesaj rruge do te realizohet ne dy faza

- Faza e Pare Kika te Dragobis - Qafa e Pajes
 - Faza e Dyte Qafe Paje – Bradozhnica
2. Ndertimi i rruges per fazen e I-re do te filloje ne vendin e quajtur Kikat e Dragobise (rreth 2060 ml nga rruga Bajram Curri – Valbone) ne kuoten 0.+805 m, do te kaloje nga Gjarpni i Dragobise ne kuoten 1.+090 m, Livadhet e Gurihulit ne kuoten 1.+230 m – Prroi i Milloshit 1.+220 m – Siper teles se Margegaje, Kosherisht ne kuoten 1.+500 m dhe ne Qafen e Pajes ne kuoten 1.+630 m.
3. Edhe ky segment nga ana ndertimore ndahet ne tre pjesë, si me poshte:

-Segmenti i I-re Kikat e Dragobise - Gjarpni i Dragobise - Livadhet e Gurihulit, me një gjatesi, prej 5.0 km do te kaloje, thaujse plotesisht, neper trasene e vjetër (ekzistuese), ndertuar para viteve '90, ku do te kete permiresime te trases, permirsim te ndonje kthese, germimin e kanalit ansore, shtresa prej çakulli e vendosje tombinosh ne 3-4 perroje te vegjel pademtuar bimesie te ulet, apo te larte.

-Segmenti i II-te, nga Gurihuli deri ne vendin e Quajtur Prroi i Milloshit u studjuar ne dy variante nga poshte shkembit dhe nga siper. Duke pare se varianti nga poshët shkembit ka një kosto shume te larte per germimin e shkembit, per një gjatësi 600 ml u zgjodh variant i kalimit nga siper.

-Segmenti i III-te, nga Prroni i Milloshit - Telat e Margegaje - Cerropoje - Qafa e Pajes, ne kuoten 1.+634 m e gjatesi rruge 2.1 km, apo gjatesi progresive 11.6 km, eshte segmenti me i lehte per tu realizuar nisur kjo nga formacioni i terrenit.

Rruga do te ndertohet me një gjeresi kaluese prej 3m, me shtrese çakulli macadam, me trashesi $t = 10\text{--}15 \text{ cm}$ dhe bankinat, $2 \times 0.5 \text{ m}$. Kanali anesor ne gjatesi te konsiderueshme, nuk ka nevoje te realizohet, pasi bazamenti kalon komplet mbi zona te filtrueshme.

Siq trajtuam me lart, ne segmentin e I-re, me gjaetsi 5.0 km nuk kemi demtim te bimesise, pasi gjurma ekzistuese eshte ne gjeresine e kerkuar per ndertimin e rrugeve te kesaj kategorie, ndersa per pjesen tjeter, ku rruga kalon pjeserisht, neper pyll edhe ketu, demtimet jane te pa konsiderueshme, pare kjo dhe na baze te udhezimeve te ministrise perkatese, pasi kurora e rruges eshte 8-9m, pra me e vogel se kurora e drureve ne kete zone.

Duhet theksuar se vetem per një gjatësi prej 1.4 km nga Gjarpni i Dragobise, deri ne vendin e quajtur Tela e Sonopatit, traseja hapet e re dhe kjo kalon ne një zone 95% te zhveshur siq pasqyrohet dhe ne fotot qe shoqerojne kete material, ndersa pjesa tjeter, per një gjatesi rreth 5 km, ne dy segmented, 80% kalon ne rrugen kambesore (rruge kali), e cila ne pjesen dermuese te saj ka një gjeresi mbi 3m.

Ne baze te parashikimeve paraprake, vlera e veprave te artit arrin ne 30~35% te vleres, ku per rruge te kesaj kategorie, eshte normale deri ne 40 e vleres se per gjithshme. Ne vleren e larteppermendor perfshihet edhe ndertimi i një ure ne vendin e quajtur Prroni i Milloshit.

Te per gjithshme

-Nisja e segmentit rugor ne Kika te Dragobise, ne kuoten 805 m mbi nivel te detit, distance progresive = 0+000, me kordinata $42^{\circ} 27' 06.32'' \text{ N}$ e $19^{\circ} 57' 01.43'' \text{ E}$

-Kthesa e madhe Gjarpnit te Dragobise, ne kuoten 1109 mbi nivel te detit, distance progresive = 3+500, me kordinata $42^{\circ} 26' 49.30'' \text{ N}$ e $19^{\circ} 58' 21.57'' \text{ E}$ Dh=307 m, i = 9%.

-Kthesa e dyte, Gjarpni i Dragobise, ne kuoten 1198 m mbi nivel te detit distance progressive = 4+500

Me kordinata $42^{\circ} 26' 48.8'' \text{ N}$ e $19^{\circ} 58' 21.5'' \text{ E}$ Dh= 89 m, i = 9%.

-Kthesa mbi Antena, ne kuoten 1290 m mbi nivel te detit, distance progressive = 5+350

Me kordinata $42^{\circ} 27' 19.56'' \text{ N}$ e $19^{\circ} 58' 03.07'' \text{ E}$ Dh= 31 m, i = 3.6%.

-Fundi i livadhit mbi shkemb (stani i pare) ne kuoten 1439 m mbi nivel te detit, distance progresive = 6+900, me kordinata $42^{\circ} 26' 57.88''$ N e $19^{\circ} 58' 54.11''$ E Dh= 210 m, i = 13.5 %.

-Prroi i Milloshit ne kuoten 1319 mbi nivel te detit distance progressive = 8+300

Me kordinata $42^{\circ} 27' 12.28''$ N e $19^{\circ} 59' 50.58''$ E Dh= 120 m, i = 8.6 %.

-Kurrizi Kosherishte (para Kosherishte), ne kuoten 1482 m mbi nivel te detit distance progressive = 9+250, me kordinata $42^{\circ} 26' 46.08''$ N e $20^{\circ} 00' 07.22''$ E Dh= 163 m, i = 17 %.

-Qafa e Pajes ne kuoten 1634 m mbi nivel te detit, distance progressive = 11+400, me kordinata $42^{\circ} 26' 24.25''$ N e $20^{\circ} 01' 32.04''$ E Dh= 152 m, L= 2150, i = 7.1 %.

-Livadhi Stanagjeç, ne kuoten 1621 m mbi nivel te detit distance progressive = 11+600, me kordinata $42^{\circ} 26' 24.25''$ N e $20^{\circ} 01' 32.04''$ E Dh= 23 m, L= 200, i = 11.5 %.

Ky segment rrugore qe po parashikojme te ndertojme, per nje gjatesi prej 11.6km 5 km i ka te realizuara para viteve '90 ndersa 6.6 km do te realizohen me trase te re.

III. TE DHENA TE PER VOLUMET

Ne total per fazen e l-re per gjatsin 11.6 km kemi:

Nga fillimi i segmentit rrugor Kika te Dragobise, deri ne Gjarpen te Dragobise, per nje gjatesi 5.0 km, kemi vetem zgjerim ne disa raste kryesish, kthesat te rruges ekzistuese, ndersa nga Gjarpni i Dragobise, deri ne Qafe te Pajes, do te realizohet trase e re.

Ne total per ndertimin e ketij segmenti rrugor do te realizohen keto volume:

-Germime per trup rruge ne formacione dheu = 23500 m³

-Germime per trup rruge ne formacione shkembore = 7700 m³

Germime per kanalet anesore e themele per vepra arti = 4800 m³

-Mbushje me material te germuar me pare = 3500 m³

-Mure mbajtse e priteze butobetoni = 1150 m³

-Tombino b/armi Ø 800 mm = 140 ml

-Ure Hd-4m prroni i Milloshit

-Nenshtresa prej cakulli t= 20 cm ne formacione te buta per nje gjatsi prej 3 km = 9000 m²

-Shtres me çakull macadam t= 10 ~ 15 cm ne gjithe gjatsin e rruges = 34800 m²

-Drenazhe gjatsore e terthore rruges me gure 120 m³

Keto me nje vlore, sipas preventivit qe paraqitet bashkangjitur ketij relacioni, per shumen prej 93 000 000 leke.

Bashkngjitur paraqesim dhe kerkesat e paraqitura nga kryepleqet e fshatrave qe perfitojne nga ndertimi i kesaj rruge.

HARTOI

Studio "Land Point-AL"

Ing. Mentor ÇOKAJ

